

AKT NORMATIV
Nr.1, datë 2.4.2009

**PËR DËRGIMIN E NJË KOMPANIE TË FORCAVE TË ARMATOSURA NË
REPUBLIKËN E ÇADIT DHE NË REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE, SI
KONTRIBUT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MISIONIN “MINURCAT” TË
ORGANIZATËS SË KOMBEVE TË BASHKUARA**

Në mbështetje të neneve 12, pika 3, dhe 101, të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dërgimin e një kompanie të Forcave të Armatosura në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore, në kuadër të kontributit të Republikës së Shqipërisë, në misionin “MINURCAT” të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në zbatim të rezolutës nr.1861, datë 14.1.2009 të Këshillit të Sigurimit.

Neni 2

Misioni i autorizuar i kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë do të jetë sigurimi dhe ruajtja e Shtabit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në N’Djamena, kryeqytet të Republikës së Çadit.

Neni 3

Ushtarakët, që do të marrin pjesë në misionin “MINURCAT”, të OKB-së, për ditët e qëndrimit në këtë mision, do të marrin, veç pagës mujore, edhe një shpërblim ditor, për vështirësi shërbimi, në masën, që do të caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Shpenzimet për pjesëmarrjen e kompanisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë operacion do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, të lidhura për këtë qëllim.

Neni 5

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha